



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 615 Prot

Tiranë, më 31.3.2021

URDHËR

Nr. 36, datë 31/3/2021

**“PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 188, DATË 18.12.2020 "PËR
MIRATIMIN E REGJISTRIT TË KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE TË
RISHIKUAR" TË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të gërmës “c” të nenit 4 dhe neneve 5 e 6 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

URDHËROJ:

1. Në pikën 2, të Urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, fjalët “... jo më vonë se data 31 mars 2021” ndryshohen në “... jo më vonë se data 30 qershor 2021”.
2. Ngarkohen autoritetet publike për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

